

VENDIM
Nr. 252, datë 10.4.2026

**PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 145, DATË 20.2.2013,
TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR PJESËMARRJEN E FORCAVE TË
ARMATOSURA TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË ME PËRFAQËSUES NË
SHTABIN ‘EUFOR’, NË KUADËR TË OPERACIONIT USHTARAK ‘ALTHEA’, TË
BASHKIMIT EVROPIAN, NË BOSNJË-HERCEGOVINË”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 1, të nenit 7, të ligjit nr. 9363, datë 24.3.2005, “Për dërgimin e Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë jashtë vendit, si dhe për mënyrën e procedurat e vendosjes dhe kalimit të forcave ushtarake të huaja në territorin e Republikës së Shqipërisë”, dhe të shkronjës “ç”, të nenit 11, të ligjit nr. 64/2014, “Për pushtetet dhe autoritetet e drejtimit e të komandimit të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr.145, datë 20.2.2013, të Këshillit të Ministrave, “Për pjesëmarrjen e Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë me përfaqësues në shtabin ‘EUFOR’, në kuadër të operacionit ushtarak ‘ALTHEA’, të Bashkimit Evropian, në Bosnjë-Hercegovinë”, të ndryshuar, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

- a) Pas shkronjës “b”, të pikës 1, shtohet shkronja “c”, me këtë përmbajtje:
“c) të 1 (një) përfaqësuesi të Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes në shtabin “EUFOR.”.
- b) Në pikën 3, fjalët “Kohëzgjatja për çdo rotacion është 6 (gjashtë) muaj ...” zëvendësohen me “Kohëzgjatja për çdo rotacion është deri në 6 (gjashtë) muaj ...”;
- c) Në pikën 4, fjalët “... përfaqësuesit ushtarak ...” zëvendësohen me fjalën “... personelin ...”.

2. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, përballohen nga fondet e miratuara për buxhetin e Ministrisë së Mbrojtjes.

3. Ngarkohet ministri i Mbrojtjes për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama